

AKT THEMELIMI
I
SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"CNS SERVICES AND PROPERTY MANAGEMENT" sh.p.k.

Në Durrës, sot më datë 04.01.2024 (dymijë e njëzet e kater), personi fizik:

Z. Kristi Leshja, atësia Anesti, amësia Anila, i lindur më 19.12.1993, në Durres dhe banues në Durres, me adresë Filonid Durrsaku, Nd.1, H 33, Ap 11 shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet Kartes Identitetit me Nr. 037261839 dhe Nr. personal J31219042V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Vendosi sa vijon:

NENI 1

Themelohet shoqëria tregtare :« CNS SERVICES AND PROPERTY MANAGEMENT » Sh.p.k

Ortaku themelues i saj është:

a) **Z. Kristi Leshja 100%.**

Shoqeria tregtare « CNS SERVICES AND PROPERTY MANAGEMENT » Sh.p.k, do të jetë shoqëri me përgjegjesi të kufizuar.

Emërtimi i shoqërisë do të jetë i stampuar dhe ne vulën e saj.

NENI 2

4.1 Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Durrës, Lagjja Nr. 4 Rruga 7 Marsi, Pallati "Firma Valoti", Kulla 1, Prane drejtorise se Hekurudhes, Durres.

NENI 3

Shoqëria e shtrin aktivitetin e saj tregtar në të gjithë juridikcionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit. Me vendim të ortakut, mund të krijohen ose anullohen (në rast se janë çelur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqiperise dhe jashtë saj.

Njësítë e tjera strukturore të shoqerisë si degë apo përfaqësi edhe jashtë shtetit krijohen kur një gjë të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.



NENI 4 **Kapitali i shoqërisë**

1. Kapitali fillestari i shoqërisë është 10 000 lekë. Pjesemarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është 100 % i kapitaleve të shoqërisë. :
2. Ortaku themelues **Kristi Leshja** është zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 10 000 lekë, që përbën 100 % të kapitalit themeltarë të shoqërisë.

Shoqëria mund të ndryshojë kapitalin themeltar; Transferimi i kuotave kushtëzohet nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë;

Po kështu transferimi i Kuotave bëhet sipas neneve 72; 73 ;74 ;75 dhe përgjithësisht siç parashihet në ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008. Të gjitha transferimet kanë efekt mbi shoqërinë që nga momenti i regjistrimit në librin e Ortakëve.

Ortaku ka të drejta pronësie mbi çdo lloj kapitali, mjeti xhiroje si dhe mbi çdo lloj pasurie tjetër të fituar në rrugë të ligjshme. Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është me një afat të pacaktuar.

NENI 6

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me Legjislacionin Shqiptar në fuqi si dhe mbi bazën e këtij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Pjesët e kapitalit janë lirisht të transferueshme në rrugë trashegimie, në përputhje me ligjin dhe statutin.

NENI 8

Shoqëria « **CNS SERVICES AND PROPERTY MANAGEMENT** » sh.p.k. krijohet për të ushtruar aktivitetin e saj konform objektit që do të jetë:

Qender Estetike, administrim/menaxhim pallatesh, zyrash etj. Përveç veprimtarive të parashikuara më lart në veprimtarinë sipermanrese të shoqërisë do të hyjë çdo veprimtari tjeter industriale, tregtare, financiare dhe që do të konsiderohet nga ortaku e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk ndalohet nga ligji.

NENI 9

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtimet të tjera të cilat janë me interes për mbarëvajtjen e shoqërisë.



NENI 10

Me vendim të Asamblesë së ortakëve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 11

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është Organi me i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji " Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare " i njeh asamblesë së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortakët mund t'ia delegojnë kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej tyre ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë.

NENI 12

Administratori i Shoqërisë do të jetë:

Z. Kristi Leshja, atësia Anesti, amësia Anila, i lindur më 19.12.1993, në Durres dhe banues në Durres, me adresë Filonid Durrsaku, Nd.1, H 33, Ap 11 shtetas shqiptar, i identifikuar nëpërmjet Kartes Identitetit me Nr. 037261839 dhe Nr. personal J31219042V, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Administratori i shoqërisë, Z. Kristi Leshja, emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të këtij akti.

NENI 13

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 kopje originale, me të njëjtën vlerë ligjore, një kopje depozitohet në Qëndrën Kombëtare të Biznesit.

Ky akt u lexua dhe u kup tua nga nënshkruesi i cili deklaron se akti është i rregullt tërësisht dhe në çdo paragraf në përpunje me vullnetin e lirë e të plotë të tij, jep pëlgimin për sa përmendet në akt dhe nënshkruan rregullisht në çdo faqe dhe emër, mbiemër dhe firmë në mbyllje të aktit.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISË TREGTARE

"CNS SERVICES AND PROPERTY MANAGEMENT" sh.p.k.

Kristi Leshja

KRISTI LEŠHA 



Scanned with
MOBILE SCANNER